



## Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 04.05.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës **01.05.2022** të parashtruar nga OE **Cleansweep Power Shpk, - Prishtine**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Pastrimi dhe mirëmbajtja e objekteve të komunës së Prishtinës dhe institucioneve tjera komunale**, me Nr. të Prok: **616-22-2998-2-1-1** dhe numër te brendshëm **616 22 035 211** nxjerr:

### V E N D I M

Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e OE **Cleansweep Power Shpk, - Prishtine**, të dt. 01.05.2022 lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Pastrimi dhe mirëmbajtja e objekteve të komunës së Prishtinës dhe institucioneve tjera komunale”**, me Nr. të Prok: : **616-22-2998-2-1-1** dhe numër te brendshëm **616 22 035 211**, kundër *Njoftimit për kontrate* te AK –së, të datës 07.04.2022.

1. Vërtetohet Njoftimi për kontrate i Autoritetit Kontraktues i datës 07.04.2022
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit për tenderin “Pastrimi dhe mirëmbajtja e objekteve të komunës së Prishtinës dhe institucioneve tjera komunale”*, me Nr. të Prok: **616-22-2998-2-1-1** dhe numër te brendshëm **616 22 035 211**, sipas Njoftimit për kontrate të publikuar me datën: 07.04.2022.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

### A r s y e t i m

OE **Cleansweep Power Shpk, - Prishtine** me datë 01.05.2022, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Pastrimi dhe mirëmbajtja e objekteve të komunës së Prishtinës dhe institucioneve tjera komunale”**, me Nr. të Prok: **616-22-2998-2-1-1** dhe numër te brendshëm **616 22 035 211**.


Autoriteti Kontraktues, me datë 04.05.2022, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

AK per te gjitha pretendimet tuaja konform LPP dhe RRUOPP ne baze te kerkesave per sqarime ne afatin e parapare nga OE, ka dhene sqarime shume te qarta dhe jo diskriminuese.

**AK – ka bere Njoftimin per kontrate gjithnje duke u mbeshtetur ne LPP dhe ne Rregullat e Udhezuesit Operativ per prokurim Publik, perkatesisht ne nenin Neni 51-Njoftimi i Kriereve të Përzgjedhjes, pika 1, 2 dhe 3**

AK për te ndaluar keqpërdorimet – mashtrimet nga ana e Operatoreve Ekonomik te cilat janë te shumta, këto kërkesa i ka përcaktuar edhe ne procedurat tjera te prokurimit dhe asnjëherë nuk jane cilësuar si kërkesa te pa arsyeshme dhe te pa drejta, pra është e drejte ekskluzive e zyrtarit te prokurimit për te caktuar kriteret e përzgjedhjes e jo e operatoreve ekonomik qe ti diktojnë kërkesat e tyre. AK Komuna e Prishtinës monitorohet edhe nga organet tjerat me te larta siç është KRPP por nuk ka pas asnjëherë asnjë shkrese nga ana e tyre se ky kriter është i padrejte, i pa arsyeshëm dhe diskriminues.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.



Zyrtari përgjegjës i Prokurimit